



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
MINISTRI

URDHËR

Nr. 469, datë 27.12.2019

PËR

“PËRCAKTIMIN E DENDËSISË SË PIKAVE TË AKSESIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR”

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 7 të nenit 6 dhe pikës 3 të nenit 12 të Ligjit Nr. 46 datë 7.05.2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në analizën e situatës aktuale për prezencën e pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postare,

URDHËROJ:

1. Përcaktimin e dendësisë së pikave të aksesit të rrjetit postar për ofrimin e shërbimit universal postar, duke marrë në konsideratë nevojat e përdoruesve për prezencë sa më të gjerë të pikave të aksesit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
2. Numri i pikave të aksesit në nivel kombëtar duhet të jetë i tillë, që të sigurojë se:
 - a) Një zyrë postare t’i ofrojë shërbimin universal postar një numri mesatar të popullsisë prej **5,500 banorë**;
 - b) Të ketë një zyrë postare mesatarisht në një sipërfaqe prej **53 km²**
3. Në zonat urbane, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit duhet të jetë mesatarisht **5 km**.
4. Në zonat rurale, distanca e zyrës postare më të afërt nga adresa e përdoruesit, duhet të jetë mesatarisht **8 km** për të paktën **95% të popullsisë**.
5. Përcaktimi zonë urbane dhe zonë rurale mbështetet në klasifikimin e përdorur në Census 2011.
6. Zyrat postare (të SHU) janë pika aksesi që ofrojnë pranimin e të gjitha llojeve të objekteve postare, pjesë e objektit të Shërbimit Universal. Në çdo zyrë postare duhet të ketë të paktën **1 (një)** kuti postare që shërben për pranimin e objekteve të thjeshta postare sipas përcaktimeve në rregulloret e UPU-së.

7. Ofruesi i shërbimit universal postar duhet të informojnë AKEP-in për çdo ndryshim të vendndodhjes së zyrës/ave postare ose të numrit të pikave të aksesit dhe duhet të japin arsyet e këtyre ndryshimeve. Në çdo rast ndryshimet nuk duhet të cenojnë përmbushjen e detyrimeve për dendësinë e pikave të aksesit sipas këtij urdhri
8. Përcaktimi i dendësisë së pikave të aksesit për ofrimin e shërbimit universal postar do të rishikohet çdo pesë vjet, por jo më vonë se 1 vit para përfundimit të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Individual të lëshuar nga AKEP për Ofruesin/Ofruesit e Shërbimit Universal Postar.
9. Ngarkohet Ofruesi i Shërbimit Universal Postar për zbatimin e këtij urdhëri dhe AKEP për ndjekjen e zbatimit të tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë, dhe efektet e zbatimit të tij fillojnë nga data 1 Janar 2020.

MINISTRI

Belinda BALLUKU